



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:013013

Datë: 20.03.2025

Numri i dokumentit: 07017713

**AC-I-23-0712- A0001-A0002**

**Në ankesën e**

***Paditësi/Ankuesi***

**E R**, të cilin e përfaqëson, avokate Z Z, Prishtinë

**Kundër:**

***E paditura/Ankuesja***

**N.SH. "N.T. Gërmia"** (në likuidim) e përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit, (AKP)**, Rruga, "Dritan Hoxha" nr.55, Lakrishtë, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Shkelzen Sylaj gjyqtar kryesues, Gazmend Sylaj dhe Ilmi Bajrami gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, E R si dhe të paditurës, AKP, të parashtruar kundër Aktgjykimit të Shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-14-6485 të datës 7 nëntor 2023, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur me 20 mars 2025, lëshon këtë:

**A K T G J Y K I M**

- 1. Ankesa e paditësit dhe e të paditurës refuzohen si të pa bazuara.**
- 2. Vërtetohet Aktgjykimi i Shkallës së parë i DHPGJS-së, C-IV-14-6485 i datës 7 nëntor 2023.**
- 3. Secila palë i bartë shpenzimet e veta.**

### **Rrethanat faktike dhe procedurale:**

Me 10 tetor 2014, paditësi/ankuesi parashtrroi kërkesë për rishqyrtim/ankesë të Vendimit të Autoritetit të Likuidimit. PRN093-0403 të datës 11 shtator 2014 ( në tekstin në vijim: Vendim i AL) me të cilin i ishte refuzuar kërkesa për kompensimin e mjeteve të asistencës sociale, më shumë prej 1,575.00 (një pesë shtatë pesë) Euro, për periudhën prej nga data 1 dhjetor 2005 e gjer me 14 gusht 2007, ndaj NSH " NT Gërmia" (në Likuidim).

Paditësi/ankuesi pohoi se me Vendimin e AL gjendja faktike nuk është vërtetuar fare sepse deri në momentin e likuidimit të NSH ishte i përfshirë në listën e pagave dhe ka marrë edhe 20% nga shitja e aseteve të Ndërmarrjes në Likuidim. Sipas tij AL-me vendim e saj ka refuzuar pa të drejtë kërkesën e tij sepse, ai është lajmëruar në punë por pa fajin e tij ai është caktuar në asistencë sociale të cilat janë marrë nga mjetet e qirave të paguara nga lokalet e NSH.

Meqë, sipas paditësit/ankuesit, NSH" Gërmia" nuk ka qenë duke funksionuar si ndërmarrje prodhuese, prej momentit të likuidimit punëtorët kanë kërkuar asistencën sociale të pa paguar prej vitit 1 janar 2005 e gjer me 14 gusht 2007 në shumë prej 1,575€ që do të thotë 50.00 € në muaj. Përfundimisht paditësi/ankuesi kërkoj nga gjykata, që të merr vendim dhe të vendos në mënyrë meritore në këtë çështje.

Paditësi/ankuesi, kërkesës së tij për rishikim/ankesës i ka bashkëngjitur:

- kopjen e Vendimit të AL,
- kopjen e formularit kërkesës për Likuidim të datës 13 tetor 2007, dhe
- kopjen e vendimit mbi asistencën sociale, lëshuar nga NSH, nr.388 i datës 15 gusht 2002.

Me 30 gusht 2023, shkalla e parë, ka dërguar një urdhër për paditësin ankuesin me të cilin u kërkuar që të parashtrohen prova shtesë siç është Vendimi mbi asistencën sociale për periudhën e pretenduar (janar 2005 deri gusht 2007).

Duke vepruar sipas urdhrit, me 28 shtator 2023, paditësi/ankuesi ka parashtruar parashtresën për plotësim të ankesës si dhe autorizimin e dhënë përfaqësueses.

Parashtresës për plotësim të ankesës i janë bashkangjitur :

- kopja e librezës së punës,
- kopja e vendimit nr.496 te datës 26.06.2000 të lëshuar nga NSH,
- kopja e listës së punëtorëve ne asistencë sociale, për periudhën janar –dhjetor te vitit 2005, në të cilën sipas numrit rendor nr. 40 figuron ankuesi/paditësi dhe shuma e asistencës. Kjo listë e vulosur dhe nënshkruar nga NSH-përfaqësuesi i saj (në tekstin në vijim LISTA E ASISTENCËS SOCIALE), dhe
- Kopja e listës së punëtorëve të cilët kanë plotësuar kriteret për përfitimin e të hyrave të 20% nga NSH "Germia".

Bazuar në urdhrin e gjykatës, me 03.11.2023 e paditura/ankuesja, AKP, parashtroj përgjigjen/mbrojtjen.

AKP pohoi se AL ka bërë një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore janë zbatuar saktësisht. Tutje AKP konsideroj se kërkesa e parashtruesit është refuzuar duke u bazuar në faktet dhe bazat ligjore, nenit 36.2.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP-në, parashikon " elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një kërkesë apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë...dokumentacioni për kërkesën apo interesin e pretenduar i paraqitur nga kreditori i pretenduar mbetet jo i plote edhe pas kërkesës nga kreditori i pretenduar për dokumentet apo dëshmi plotësuese ". Më tutje, AKP, thekson se ankesa e paditësit/ankuesit është e pa pranueshme. AKP konsideron se është e rëndësishme të theksohet se objekt i kësaj procedure gjyqësore është vetëm ligjshmëria (përputhshmëria me Ligjin 04/L-034) e Vendimit të Autoritetit të Likuidimit. Në këtë kontekst, 74.2 i Ligjit 06/L-086 parashikon që ankesat e dorëzuara në DHPGJS kundër vendimeve të AL-së duhet të bazohen në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në përputhje me Ligjin 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Sipas AKP-së paditësi/ankuesi nuk ka treguar se cili nen i Ligjit 04/L-034 është shkëlur nga AL-ja në marrjen e Vendimit, dhe në këtë mënyrë ka shkëlur nenin 74.2 i Ligjit 06/L-086 i cili parashikon që ankesat e dorëzuara në DHPGJS kundër vendimeve të AL-së duhet të bazohen në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në përputhje me Ligjin 04/L-034 për

Agjencinë Kosovare të Privatizimit.. Përfundimisht AKP propozoj që ankesa të hedhet si e pa pranueshme ose refuzohet si e pa-bazuar dhe që vendimi i AL-së të vërtetohet.

Me 7 nëntor 2023, Shkalla e parë e DHPGJS-së, merr Aktgjykimin C-IV-14-6485, me të cilin ndryshoj Vendimin e AL, si dhe ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesën e paditësit/ankuesit si të bazuar ashtu që obligon të paditurën, AKP, që paditësit në emër të kompensimit të asistencës sociale ti paguhet shuma prej 546.00 (pesë katër gjashtë) Euro, gjersa pjesën tjetër të mbetur e refuzoj sit ë pabazuar.

Kundër Aktgjykimit të Shkallës së parë, si më lartë të përshkruar, C-IV-14-6485 datë 17 nëntor 2023, ankesë parashtruar paditësi si dhe e paditura.

Ankuesi/paditësi, E R, ankesën e tij e parashtrorj me 27 nëntor 2023 (në tekstin në vijim Ankuesi 1) gjersa e paditura/ankuesja, AKP, po ashtu ankesën e saj e parashtrorj po me 27 nëntor 2023 (Ankuesi 2).

### Ankuesi 1

Ankuesi/Paditësi, Aktgjykimin e Shkallës së parë, e kundërshtoj për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të dispozitave materiale të Ligjit për AKP.

Sipas ankuesit/paditësit, vërtetimi i gabuar i gjendjes faktike konsiston për faktin se i njëjti ka parashtruar prova, si Vendimin mbi asistencën sociale dhe librezë e punës nuk ju ka mbyllur asnjëherë. Ankuesi/paditësi pohon se ishte i përfshirë në listën e punëtorëve me të drejtë pjesëmarrje në 20% nga privatizimi i NSH dhe se nga data 1 janar 2005 që të gjithë punëtorët nuk kanë marrë paga. Ankuesi i referohet Vendimeve të DHPGJS.

Sipas ankuesit/paditësit, sa i përket zbatimit të gabuar të dispozitave materiale, konsideron se AL ka zbatuar gabimisht dispozitën e nenit 35 paragrafi 2 pika 2.5, të Ligjit (nr. 04/L-034) për AKP. Sipas ankuesit/paditësit, kërkesa e tij mbi asistencën bazohet në dispozitën e cekur si më lartë.

Nga të gjitha arsyet, ankuesi/paditësi kërkoj nga Kolegji i Apelit që Aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj ashtu që kërkesën e tij ta aprovoj si të bazuar apo Aktgjykimin e ankimuar ta prishë dhe çështjen ta kthej në rivendosje.

Përfaqësuesja e ankuesit kërkoj kompensimin e shpenzimeve gjyqësore në shumë totale prej 514.00 Euro.

Ankesës i janë bashkangjitur, si kopje e Vendimit të DHPGJS, kopje të Njoftimit mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës dhe kopje të njëjta si pranë procedurës në Shkallë të parë.

Bazuar në urdhrin e gjykatës, AKP me 23 gusht 2024 parashtroj përgjigje në ankesë.

AKP thekson se Aktgjykimi i ankimuar është i bazuar në ligj dhe prova dhe si i tillë duhet të vërtetohet. Në vijim AKP, lidhur me kërkesën e paditësit/ankuesit, pohon se tani më është deklaruar në procedurë të Shkallës së parë andaj përsëritja e argumenteve do të konsiderohej e padobishme për mbarëvajtjen e procedurës. AKP i referohet Vendimit të DHPGJS. Përfundimisht AKP propozoj që ankesa e paditësit/ankuesit të refuzohet dhe Aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

AKP përgjigjes në ankesë i ka bashkangjitur kopjen e Vendimit për emërimin e anëtarëve të AL.

### Ankuesi 2

E paditura/Ankuesja, Aktgjykimin e Shkallës së parë, e kundërshtoj për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të dispozitave materiale të Ligjit për AKP.

Sipas AKP/ankueses 2, Aktgjykimi i ankimuar nuk përmban prova e të cilat duhet të mbështeten në bazë të nenin 54 dhe nenin 9 paragrafi 4 pika 2 të Ligjit (nr. 06/L-086) për DHPGJS.

Në vijim po sipas të paditurës/ankueses, paditësi (Ankuesi 1) nuk i ka plotësuar kushtet ligjore, ashtu siç parashihet sipas nenit 40 paragrafi 1.6. pika 1.6.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP, që ti njihej e drejta në paga si rezultat i ndërprerjes së marrëdhënies së punës.

Nga të gjitha arsyet e paditura/ankuesja propozoj që Aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet ashtu që Vendimi i AL të vërtetohet.

Ankesës i është bashkangjitur kopja e Vendimit të AL.

Bazuar në urdhrin e gjykatës, paditësi/ankuesi (Ankuesi 1) me 29 gusht 2024 parashtrorj përgjigje.

Ankuesi/paditësi (Ankuesi 1) kundërshtoj ankesën e të paditurës/ankueses (Ankueses 2). Në përgjigje, paditësi pohon se pranë NSH ishte i punësuar që nga viti 1972 e gjer 1990 e pas luftës në vitin 1999 është lajmëruar në punë por për shkak të rrethanave biznesore ankuesi është caktuar në asistencë sociale. Ankuesi/paditësi pohoj se ishte i përfshirë në listën e punëtorëve me të drejtë pjesëmarrje në 20% nga privatizimi i NSH, si dhe qëndroj nga të gjitha pohimet e tij sikurse në ankesën e tij. Edhe me këtë përgjigje, ankuesi/paditësi propozoj që të obligohet AKP që të ja kompensoj shumën e kërkuar duke përfshirë edhe kamatën ligjore prej 8%.

Përfaqësuesja e ankuesit, kërkoj kompensimin e shpenzimeve gjyqësore në shumë prej 208.00 Euro si dhe në emër të, siç thekson, dy ankesave shumë prej 108.00 Euro si dhe në emër të taksës gjyqësore shumë prej 21.00 Euro.

### **Arsyetimi ligjor**

Ankesat e paditësit/ankuesit (Ankuesit 1) dhe e të paditurës/ankueses (Ankuesi 2) janë të pabazuara.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit (nr. 06/L-086) mbi DHPGJS, Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

## **Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit**

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-14-6485 të datës 7 nëntor 2023, është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj ai duhet të vërtetohet.

Libreza e punë, LISTA E ASISTENCËS SOCIALE dhe NJOFTIMI, dëshmi këto të parashtruara nga paditësi/ankuesi (Ankuesi 1), argumentojnë faktin se i njëjti ka qenë punëtor aktiv i NSH-së, respektivisht se paditësit i janë mbetur asistencë sociale e papaguar për periudhën janar gjer dhjetor 2005, e që Shkalla e parë, në kuptim të nenit 31 paragrafi 4 dhe 5 si dhe nenit 42 paragrafi 2 dhe 3 të Ligjit (nr. 06/L-086) për DHPGJS, me të drejtë i konsideron si prova, fizike dhe/ose dëshmuese për mbështetjen e pohimeve të paditësit/ankuesit (ankuesit 1) respektivisht se këto paraqesin një pasqyrë të hollësishme të fakteve dhe arsyetimit ligjor mbi të cilin është vendosur.

Ashtu siç edhe qëndron në Aktgjykimin e ankimuar por edhe në ankesë kundër këtij Aktgjykimit të ankimuar, AKP asnjëherë nuk e ka argumentuar të kundërtën me çka ankuesit do ti mohohet e drejta në kompensimin e asistencës sociale. AKP faktet nuk i kontestuar (*positive litis contnestation*) e për më tepër provat e parashtruara, siç u cekën më lart, kanë dëshmuar pjesërisht vërtetësinë e pohimeve të palës së kundërt, në këtë rast paditësit/ankuesit (Ankuesit 1).

E paditura/ankuesja me ankesën e saj kundër Aktgjykimit të ankimuar lidhur me dispozitat ligjore të aplikueshme pohon se paditësi nuk i ka plotësuar kushtet ligjore të parapara sipas nenit 40 paragrafi 1 pika 1.6.2 të Ligjit (nr. 04/L-034) për AKP, me të cilën parashihet përmbushja e kërkesave për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës të sjella nga punonjësit të cilat janë pushuar nga puna si rrjedhojë e Vendimit për Likuidim të ndërmarrjes.

Kolegji i Apelit konsideron se kërkesa e paditësit nuk konsiston për përmbushje për dëmshpërblim për shkak të ndërprerjes së parakohshme të kontratës së punës por kërkesë për kompensim të asistencës sociale, ashtu siç edhe qëndron në Vendimin e AL.

Shuma mbetur përtej shumës së aprovuar, ashtu siç është vendosur nga Shkalla e parë, paditësi/ankuesi (Ankuesi 1) nuk e ka dëshmuar. LISTA E ASISTENCËS SOCIALE, tregon vetëm se periudhën e asistencës sociale të papaguar nga NSH për periudhën janar – dhjetor 2005 si dhe shumën e aprovuar, prej 564.00 Euro e jo edhe shumën e kërkuar prej 1,575.00 Euro dhe periudhën tjetër të mbetur nga muaji janar 2006 e gjer muajin gusht të vitit 2007.

Andaj ashtu siç edhe Shkalla e parë ka vendosur po ashtu edhe Kolegji i Apelit konsideron, edhe përkundër pretendimeve ankimore, të paditurës/ankueses, paditësi në rastin konkret i ka plotësuar kushtet ligjore të parapara sipas nenit 40 paragrafi 1 pika 1.7 të Ligjit (nr. 04/L-034) për AKP mbi kompensimin e pagave të papaguara, sepse siç edhe është cekur si më lartë të gjitha provat dhe dëshmitë e parashtruara argumentojnë faktin se paditësi ka qenë punëtor aktiv i NSH-së respektivisht se të njëjtit i janë mbetur asistencë sociale të papaguara.

Gjatë shqyrtimit të Ankesave, si të paditësit/ankuesit (Ankuesit 1) por edhe të paditurës/ankuesit (Ankuesit 2), Kolegji i Apelit gjeti se AKP në përgjigjen e saj ndaj ankesës së paditësit/ankuesit (Ankuesit 1) pohoj se Aktgjykimi i ankimuar i shkallës së parë është i bazuar në ligj dhe prova dhe si i tillë duhet të vërtetohet gjersa me ankesën e saj e kundërshtoj po të njëjtin Aktgjykim si të pabazuar. Kjo pasqyrë, nga përgjigja në ankesë në një të anën dhe ankesë në anën tjetër, paraqet një pasqyrë kontradiktore me kërkesa të kundërta, drejtuar gjykatës nga ana e AKP (paditëses/ankueses), aq më tepër kur përfaqësuesi i AKP është person i njëjtë në dy rastet.

Prandaj nga të gjitha këto arsye, ankesat e paditësit/ankuesi dhe e të paditurës/ankueses është refuzuar si e pa bazuar ndërsa është vërtetuar Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së parë i DHPGJS-së si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Andaj, në bazë të nenit 9.10 të Ligjit për DHPGJS, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

### **Taksa gjyqësore**

Ankuesi 1 dhe Ankuesi 2 kanë paguar taksat gjyqësore.



Në pajtim me nenin 62 të Ligjit për DHPGJS, lidhur me shpenzimet gjyqësore dhe kërkesës së përfaqësuesit të paditësit/ankuesit, Kolegji i Apelit vendosi që secila palë do ti bartë shpenzimet e veta.

Lëshuar nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 20 mars 2025.

Shkelzen Sylaj, Gjyqtar Kryesues

\_\_\_\_\_